

VENDIM
Nr. 80, datë 6.2.2026

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË
PRONËSISË INDUSTRIALE PËR VITIN 2026**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 189/c, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e buxhetit për Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale për vitin 2026, sipas tabelës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

BUXHETI I DPPI-së PER VITIN 2026

Të ardhurat	000/lekë	Shpenzimet	000/lekë
Të ardhura nga aktiviteti kryesor	197,000	Shpenzime personeli	110,400
Të trashëguara investime dhe projekte në vazhdim	67,418	Shpenzime operative dhe korrente	48,225
Të trashëguara, detyrime për organizata ndërkombëtar	63,473	Transferta korrente të jashtme + te brendshme	132,800
Marrëveshja e Madridit	65,000	Shpenzime kapitale	103,056
Marrëveshja e Hagës	1,500	Totali i shpenzimeve	394,481
Të ardhura nga marrëveshja e shtrirjes me ZEP	90	Teprica derdheje në buxhetin e shtetit	0
Totali i të ardhurave	394,481	Totali i shpenzimeve dhe teprica në Buxhetin e Shtetit	394,481